

**RREGULLAT PER ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E PLATFORMES**

UNION CHANGE

Varianti 1

Datë: Prill 2025

1.	ANETARESIMI	4
1.1.	Autorizimi dhe pranimi	4
1.2.	Pershtatshmeria.....	4
1.3.	Detyrimet e vazhdueshme te anetareve	4
1.4.	Pezullimi ose perfundimi i pjesmarrjes se nje Anetari	6
1.5.	Konfidencialiteti	6
1.6.	Terheqja e anetareve nga pjesmarrja ne Union Change	6
2.	PAGESAT	7
2.1.	Komisionet	7
2.2.	Taksat	7
3.	LAJMERIMET DHE AMENDIMET	7
3.1.	Lajmerimet	7
3.2.	Ndryshimet	8
4.	PERGJEGJESITE E ANETAREVE	8
4.1.	Veprime apo sjellje te palejuara	8
5.	RREGULLAT E TREGTIMIT	9
5.1.	Monedhat e tregtuara ne Union Change	9
5.2.	Hyrja ne Union Change	9
5.3.	Vendosja e urdherave	9
5.4.	Perputhja e urdherave	9
5.5.	Orari i tregtimit.....	10
5.6.	Vendosja dhe fshirja e urdherave	10
5.7.	Administrimi i udherave.....	10
5.8.	Pezullimi i ekzekutimit automatik.....	10
5.9.	Fshirja e nje transaksioni	11
6.	RREGULIMI DHE PASTRIMI I LLOGARIVE	11
6.1.	Kunderpala Qendrore	11
6.2.	Procesi i rregullimit dhe pastrimit te llogarive	11
7.	DESHTIMI	12
8.	INFORMACIONI, MONITORIMI DHE HETIMI.....	12
8.1.	Monitorimi.....	12
8.2.	Informacioni	12
8.3.	Hetimi i shkeljeve.....	13
8.4.	Ndihma ne hetim	13

8.5.	Sanksionet.....	13
8.6.	Ankesat.....	14
8.7.	Heqje dore	14

1. PERCAKTIMI I TERMAVE

Operatori	Departamenti i Thesarit ne Union Bank;
Aplikues	nje subjekt qe kerkon te Behet Anetar ne perputhje me sekionin 1;
Anetar	nje anetar i Union Change qe eshte anetaresuar ne baze te seksionit 1, qe eshte i afte te vendosi urdhera ne Union Change;
Autoriteti Kompetent	Autoriteti rregullator i Anetarit;
Dite pune	ditet kur bankat jane te hapura ne Shqiperi, pra te gjitha ditet pervec te shtunave dhe te dielave si dhe festat zyrtare te Republikes se Shqiperise;
Falimentim	nje prej ngjarjeve te meposhtme: <ul style="list-style-type: none">a) nje Anetar eshte I paaft te paguaj ne kohen e duhur detyrimet e tij, pezullon kryerjen e pagesve ose borxheve ose, per shkak te veshtiresive financiare aktuale apo te pritshme, fillon negocime me nje ose me shume kreditore te tij me qellim riskedulimin e ndonje prej borxheve te tij;b) vlere e te drejtave te nje Anetari eshte me e vogel se vlere e detyrimeve te tij;c) deklarohet nje moratorium ne lidhje me ndonje prej borxheve te Anetarit;
Kunderpale Qendrore e Shlyerjes	Union Bank sh.a.
Marreveshje e Anetaresimit	marreveshja mes nje Anetari dhe Union Change ne lidhje me anetaresimin ne Union Change;
Ngjarje Deshtimi	ndodh kur nje Anetar: <ul style="list-style-type: none">a) deshton te plotesoje ndonje detyrim ne perputhje me Rregulloren;b) perdor identitet te rreme;c) refuzon teresisht ose pjeserisht nje Transaksion Perkates;d) shkel Marreveshjen e Anetaresimit ne Union Change;
Rregullore	Rregullore per Administrimin dhe funksionimin e platformes Union Change sipas versionit me te fundit te perditesuar
Transaksion perkates	nje transaksion qe ndodh ne Union Change;
Union Change	Program softuerik per kryerjen e kembimeve Vautori e operuar nga Union bank sh.a.
Urdher	nje Urdher limit ose nje Urdher fleksibel
Urdher limit	nje urdher ku percaktohet shuma dhe limiti i kursit te kembimit me te cilin Anetari kerkon te kryeje nje transaksion ne Union Change.

Urdheri fleksibel	nje urdheri ku percaktohet vetem shuma qe Anetari kerkon te kembeje me cmimin e tregut (ne blerje ose ne shitje) ne Union Change;
Urdher i gabuar	nje Urdher i vendosur ne Union Change me gabime çmimi, sasie, monedhe apo krahu.

2. ANETARESIMI

2.1. Autorizimi dhe pranimi

- a) Aplikuesit qe deshirojne te anetaresohen ne platform duhet te:
 - i. Plotesojne dhe firmosin Formen e Aplikimit per Anetaresim
 - ii. Te firmosin Marreveshjen e Anetaresimit
 - iii. Te japin cdo informacion shtese qe mund te kerkohet nga Union Change
- b) Pas plotesimit te kushteve te pikes a) dhe ne perputhje me kriteret e pershtatshmerise ne seksionin 2 me poshte, anetaresimi ne Union Change do te behet efektiv ne daten e specifikuar ne njoftimin e dhene nga Union Change.

2.2. Pershtatshmeria

- a) Qe te konsiderohen te pershtatshem per pranim ne Union Change, aplikantet duhet te plotesojne te gjitha kushtet e meposhtme:
 - i. Te plotesojne kriteret e pranueshmerise se klientit per te hapur llogari rrjedhese ne Union Bank sh.a.;
 - ii. Te celin dhe mbajne nje llogari rrjedhese ne Union Bank pergjate gjithe kohes se pjesmarrjes ne Union Change per secilen nga monedhat qe Anetari deshirojne te këmbëjë;
 - iii. Te plotesojne kushtet teknike per pjesmarrje ne Union Change.

2.3. Detyrimet e vazhdueshme te anetareve

- a) Anetari është plotësisht përgjegjës për të mbrojtur Kredencialet Hyrëse në llogarinë e tij dhe mos t'i shpërndajë ato me askënd.
- b) Në rast të humbjes së Kredencialeve Hyrëse, vetëm përdoruesi i autorizuar i llogarisë së Anetarit mund të rivendosë fjalëkalimin e gjeneruar automatikisht përmes postës elektronike, të dërguar në adresën e postës elektronike të përdoruesit.
- c) Në rast se Anetari dyshon se Kredencialet Hyrëse të një përdoruesi janë duke u përdorur nga palë të paautorizuara, Anetari duhet menjëherë të raportojë në Operatorin dhe Operatori menjëherë do të ndalojë hyrjen në llogari nga ai përdorues dhe do të bllokojë përkohësisht të gjithë aksesin në të dhënat e Anetarit deri sa të zgjidhet çështja e sigurisë.
- d) Anetari dhe cilido përdorues i lidhur me llogarinë nuk krijon, transmeton, shfaq ose vë në dispozicion nëpërmjet Union Change të dhëna që janë të dëmshme (për shembull, viruset, bugs, malëaëare), ofenduese, kërcënuese, abuzive, ngacmuese, shpifëse, vulgare, të pahijshme, invazive ndaj privatësisë së dikujt, nxitëse të urrejtjes ose të paligjshme në forma të tjera.

- e) Anëtari dhe përdoruesit e tij të autorizuar mund të përdorin shërbimet e Programit Union Change dhe çdo pjesë ose element të tyre vetëm për fushën e veprimit, me mjetet dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Anëtari dhe përdoruesit e tij të autorizuar nuk mund të:
- i. përdorin Programin Union Change ose ndonjë pjesë ose element të tij për të kryer një veprë penale, të shkelin legjislacionin në fuqi apo të ftojnë të tjerët për të kryer veprime të paligjshme.
 - ii. kopjojnë, shpërndajnë, modifikojnë, përshtasin, hedhin, krijojnë vepra të derivuara, të ndryshojnë inxhinierimin ose të dekompijojnë shërbimet e Programit Union Change apo ndonjë pjesë ose element të tyre, apo të përpiqen të nxjerrin kodin burimor.
 - iii. përdorin shërbimet e Programit Union Change ose ndonjë pjesë ose element të tyre në kundërshtim me këtë rregullore.
- f) Anëtari dhe çdo përdorues i tij i autorizuar nuk mund që, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Operatori të:
- i. shesë, rishesë, japë me qira licencën, nënlicencën, shpërndarjen, zbulimin, shfrytëzimin, aksesimin ose ofrimin e shërbimeve të Programit Union Change tërësisht ose pjesërisht ndaj një personi të tretë.
 - ii. përdorë shërbimet e Programit Union Change ose ndonjë pjesë ose element të tyre në një fushë, me mjete ose për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është krijuar funksionaliteti i tyre.
 - iii. përdorë shërbimet e Programit Union Change ose ndonjë pjesë ose element të tyre me anë të programeve që dërgojnë pyetje ose kërkesa automatike, përveç nëse një programi i tillë është vënë në dispozicion nga OPERATORI.
- g) Anëtari është i detyruar të përdorë shërbimet e Programit Union Change sipas instruksioneve të OPERATORIT dhe/ose manualeve të përdorimit të dorëzuara eventualisht prej saj, të cilat mund të ndryshojnë here pas here.
- h) Anëtari merr përsipër të mbajë të pacënuar dhe të dëmshpërblejë Operatorin, drejtuesit, punonjësit dhe agjentët e saj, nga çdo pretendim, humbje, dëmtim, përgjegjësi, duke përfshirë tarifën e avokatit, që rrjedhin nga përdorimi ose keqpërdorimi prej Anëtarit apo përdoruesve të tij të autorizuar të shërbimeve të Programit Union Change, materialeve të Programit Union Change, shkeljes së kësaj Rregullore, apo e të drejtave të ndonjë personi ose subjekti tjetër.
- i) Anëtarët duhet të marrin të gjitha masat për të parandaluar vendosjen e urdherave të gabuara në Programin Union Change dhe të sigurojnë zbatimin e kësaj Rregullore në çdo kohë.
- j) Anëtarët duhet të sigurojnë në mënyrë të përshtatshme ekzekutimin e urdherave të vendosur në Programin Union Change dhe kryerjen e pagesave që rrjedhin prej këtyre transaksioneve.
- k) Anëtarët duhet të marrin masa që çdo person që vendos urdhera për llogari të tyre në Programin Union Change duhet të zotërojë njohuritë e duhura për të respektuar dhe përmbajtur kësaj Rregullore.
- l) Programi Union Change mund të mbështetet në çdo urdher, angazhim, lajmërim ose kërkesë, ose çdo lloj forme tjetër komunikimi që mund të bëhet dhe të cilin ajo e pranon në mirëbesim si të bërë nga anëtari apo në emër të anëtarit, pa ndonjë hetim të metejshëm për sa i përket vërtetësisë, autoritetit ose identitetit të personit që jep ose që mendohet se jep urdherin në fjale.
- m) Çdo anëtar duhet të plotësojë kriteret e të përshtatshmeve në çdo kohë, përgjatë anëtarësisë së tij në Union Change.
- n) Anëtarët duhet të bashkëpunojnë me Union Change dhe Autoritetet Kompetente në çdo hetim të kryer në lidhje me tregtimin në Programin Union Change.

2.4. Pezullimi ose perfundimi i pjesmarrjes se nje Anetari

- a) Operatori mund, ne lirine e tij absolute, te pezulloje, kufizojë apo perfundoje hyrjen e klienteve ne Programin Union Change, nese, ne çdo kohe, nje Anetar:
 - i. Nuk zbaton Rregulloren ose Marreveshjen e Anetaresimit; ose
 - ii. Shpall falimentin; ose
 - iii. Nuk vendos urdhera ne platformen Union Change per nje periudhe 6 mujore ose me shume; ose
 - iv. Eshte subjekt hetimi nga Autoriteti Kompetent; ose
 - v. Ndalon se plotesuari kriteret e Pershtatshmerise ose Detyrimet e Vazhdueshme;
 - vi. Ndervepron me Programin Union Change ne nje menyre qe administratoret e Union Change e konsiderojne, ne lirine e tyre, te jete jo ne perputhje dhe pershtatshmeri me veprimin dhe mirembajtjen e nje tregu te barabarte dhe te rregullt,
- b) Operatori do te pezulloje, kufizojë ose perfundoje hyrjen e Anetarit ne Programin Union Change nese i kerkohet nga ana e Bankes se Shqiperise ose ndonjë Autoritet tjetër kompetent.
- c) Operatori mund te perfundoje ne menyre definitive hyrjen e Anetarit ne Programin Union Change duke i dhene atij nje lajmerim paraprak per nje periudhe 1-mujore.
- d) Anetari do te njoftohet me shkrim per çdo veprim te ndermarre, propozuar per t'u ndermarre, nga Operatori ne perputhje me kete Rregullore.

2.5. Konfidencialiteti

- a) Operatori do te trajtojë si konfidencial çdo informacion te marre nga Anetaret ne lidhje me çdo transakcion te kryer ne Union Change perveçse kur:
 - i. Informacioni eshte i disponueshem publikisht;
 - ii. Dhenia e informacionit kerkohet nga ligji ose nga ndonje autoritet tatimor apo rregullator;
 - iii. Dhenia e informacionit eshte ne perputhje me çdo investigim rregullator te kryer nga Autoriteti Kompetent;
 - iv. Dhenia e informacionit lejohet shprehimisht ne ligj;
 - v. Dhenia e informacionit eshte dakordesuar me shkrim nga Anetari; ose
 - vi. Zbulimi i informacionit eshte bere per te lehtesuar kryerjen e pagesave qe rrjedhin nga transakcionet perkatese ne Union Change.

2.6. Terheqja e anetareve nga pjesmarrja ne Union Change

- a) Anetaret mund te terhiqen nga pjesmarrja ne Union Change, duke dhene nje njoftim paraprak me shkrim, te pakten 1 muaj para, perveçse kur Operatori i Union Change, ne lirine e plote te tij, ka hequr dore nga nje njoftim i tille.
- b) Operatori i Union Change mund, ne lirine e tij te plote, te refuzojë pranimin e njoftimit paraprak te terheqjes se Anetarit nga platforma Union Change, nese konsideron se ka nje çeshtje te hapur nen hetim ne lidhje me nje Anetar (ne veçanti, pagesa te pakryera ose ndonje pozicion te pambyllur si rezultat i transakcioneve te kryera nga Anetari ne Union Change).

- c) Pavaresisht nga terheqja nga pjesmarrja ne Union Change e nje Anetari ose perfundimi i pjesmarrjes se Anetarit ne Union Change nga ana e Administrimit te Union Change, nje Anetar do te vazhdoje te mbetet i detyruar te respektoje kete Rregullore deri ne momentin me te larget kohor mes:
 - i. Dates kur te gjitha transaksionet e rendesishme jane ekzekutuar dhe paguar;
 - ii. Dates kur te gjitha komisionet ose shumat qe rrjedhin si detyrim i pjesmarrjes ne Union Change te jene paguar ne teresine e tyre.

3. PAGESAT

3.1. Komisionet

- a) Nje Anetar do t'i paguaje Union Change te gjitha komisionet, kostot e tjera dhe shumat sipas kesaj Rregullore, Marreveshje Anetaresimi ose Kushte të Punes së Union Bank, brenda afatit kohor te percaktuar nga Union Change.

3.2. Çmimi, shuma e urdhërit dhe komisionet

- a) Anëtari ka detyrimin t'i paguaje Union Change Cmimin dhe Shumen sipas kushteve të urdhërit dhe transaksionit, kushte këto te vendosura dhe pranuar nga Anëtari dhe pranuar nga Programi Union Change si edhe komisionet dhe çdo kosto tjetër sipas Kushte të Punes së Union Bank, brenda afatit kohor te percaktuar nga Union Change.

3.3. Taksat

- a) Nje Anetar do te jete pergjegjes per pagesen e çdo takse, tatimi, zbritje apo detyrimi tjetër tatimor te aplikueshem ne lidhje me tregtimin ne Union Change.

4. LAJMERIMET DHE AMENDIMET

4.1. Lajmerimet

- a) Te gjitha njoftimet nga Anetaret sipas kesaj Rregullore do te behen sa me shpejt te jete e mundur ne menyre te arsyeshme tek Administrimi i Union Change duke perdorur detajet e kontaktit qe u jane dhene Anetareve pas perfundimit me sukses te procesit te aplikimit. Nese nje njoftim eshte bere fillimisht me goje ose nepermjet postes elektronike, U change mund te kerkoje konfirmim me shkrim te ketij njoftimi,
- b) Ne vecanti, Anetari duhet te njoftoje me shkrim ose poste elektronike, ne menyre te menjehershme ndryshimet e meposhtme:
 - i. Shpallje falimenti
 - ii. Thyerje materiale e Rregullores;
 - iii. Nisja e nje hetimi apo veprimi disiplinor nga Autoritetet Kompetente ne lidhje me veprimtarite e Anetarit ne Union Change ose qe mudn te kene ndikim material ne kryerjen e detyrimeve te Anetarit sipas kesaj Rregullore;
 - iv. Nje ndryshim material me ndikim negative ne aftesine e Anetarit per te respektuar kete Rregullore.

- v. Nje ndryshim qe çon ne paaftesine e Anetarit per te plotesuar kriteret e pershtatshmerise ose Detyrimet e Vazhdueshme; ose
- vi. Nje ndryshim ne kontaktet e Anetarit ose te listes se personave te autorizuar te Anetarit (perkunder listes se paraqitur nga Anetari me plotesimin e formes se aplikimit per Anetaresim).

4.2. Ndryshimet

- a) Fuqizimi dhe shfuqizimi i Rregullores si dhe ndryshimet e pjesshme te saj, ne teresine e tyre do t'i behen te njohura Anetarit nga ana e Ubchange nepermjet mjeteve te pershtatshme, qofshin keto leter, poste elektronike, faks, njoftim ne nje ẽebbsite ẽẽẽ.unionbank.al ose menyra te tjera komunikimi. Ne rast ndryshimi material te Rregullores, Union Change mund, ne liri te plote te saj, te konsultoje Anetaret per komente.
- b) Ndryshimet di t'u behen te ditura Anetareve te pakten 7 (shtate) dite perpara se te hyjne ne fuqi.
- c) Nese ndonje ndryshim i Rregullores, pervec atyre qe kerkohen nga nje ligj i Republikes se Shqiperise ose ndonje Autoritet Kompetent, ka ndikim material negative ne te drejttat ose detyrimet e çdo Anetari, ai Anetar mund te perfundoje anetaresimin e tij ne Union Change duke bere njoftim me shkrim drejtuar Union Change brenda (5 pese) diteve nga njoftimi i derguar nga Union Change, duke respektuar, ne çdo rast, pikat 1.5 (c/i dhe c/ii).

5. PERGJEGJESITE E ANETAREVE

5.1. Veprime apo sjellje te palejuara

- a) Nje Anetar, gjate kryerjes se veprimtarise se tregtimit ne platformen Union Change, nuk do te:
 - i. Kryeje ndonje veprim apo sjellje ne shkelje te ligjeve, apo rregulloreve të Banke se Shqiperise;
 - ii. Kryeje ndonje veprim apo sjellje me synim per te krijuar nje pershtypje te rreme apo çorientuese per shumat e tregtuara dhe cmimet e kuotuar;
 - iii. Te fuse ne platform ndonje transaksion artificial (jo me qellim tregtimi real);
 - iv. Te fuse ne platform nje urdher me nje shume dhe cmim fiktiv.
 - v. Te kryeje nje transaksion te paravendosur qe ka si synim dhenien e nje pershtypje te rreme te ofertes, kerkeses ose çmimit ne treg.
 - vi. Kryeje ndonje veprim apo sjellje qe mund te demtoje barazine ose integritetin e Union Change.
 - vii. Te shkele Rregulloren.
 - viii. T'i kerkoje ose inkurajoje dike tjeter qe te kryeje ndonje prej veprimeve apo sjelljeve te parashikuara ne kete pike 4.1/a.
- b) Operatori i Union Change mund te ndermarre veprime disiplinore ne lidhje me sjelljen e Anetareve kur, ne opinionin e Administrimit te Union Change, ato perfshihen konkretisht ose potencialisht ne piken 4.1/a. Gjithsesi Operatori ruan të drejtën të përcaktojë vetë masën dhe llojin veprimeve disiplinore.
- c) Çdo Anetar do te zbatoje procedura te mjaftueshme te sigurise per te parandaluar perdorimin e paautorizuar ose keqperdorimin e Union Change kryesisht, por jo kufizuar ne:
 - i. Hyrjen ne Union Change te pesonave te paautorizuar;

- ii. Parandalimin, ndryshimin ose zhdukjen e te dhenave qe futen ne Union Change nga nje Anetar.

6. RREGULLAT E TREGTIMIT

6.1. Monedhat e tregtuara ne Union Change

- a) Administrimi I Union Change do te vendose, ne lirine e tij absolute, se cilat nga monedhat do te jene te pranueshme per tregtim ne platforme.
- b) Urdherat duhet te vendosen ne monedhat e tregtueshme ne Union Change
- c) Union Change mund, ne liri te plote, te pezulloje apo ndaloje tregtimin ne nje monedhe te caktuar ne cfaredo kohe dhe per cfaredo lloj arsye.

6.2. Hyrja ne Union Change

- a) Anetari eshte pergjegjes per te gjitha detyrimet dhe pagesat qe lindin nga vendosja, fshirja apo ekzekutimi i urdherave te dhena ne platformen Union Change nga Anetari.
- b) Operatori i Union Change rezervon te drejten te kufizojte hyrjen e Anetarit ne Programin Union Change dhe perdorimin e kesaj te fundit.
- c) operatori i Union Change rezervon te drejten qe te fshije cdo urdher te vendosur ne platforme kur kjo gjykohet e domodoshme per rrejtet e rregullsise se tregtimit.

6.3. Vendosja e urdherave

- a) Urdherat mund te jene udhera Fiks ose Fleksibel
- b) Ne rastin e urdherit Fleksibel, Anetari qe e vendos ate duhet te specifikojte shumen qe kerkon te kembeje.
- c) Ne rastin e urdherit Fiks, Anetari duhet te specifikojte shumen dhe limitin e kursit te kembimit me te cilin urdheri do te perputhet ne Programin Union Change. Urdherat Fiks do te qendrojne te hapur per tu perputhur per sa kohe qe Anetari nuk i fshin ato duke ndjekur llogjiken "Good Till Canceled".
- d) Urdherat duhet te vendosen bazuar ne specifikimet teknike qe Administrimi i Union Change do te specifikojte kohe pas kohe.

6.4. Perputhja e urdherave dhe Përputhja e pjesshme

- a) Perputhja e Urdherave

Urdherat e vendosur ne platforme do te perputhen bazuar ne kriteret e meposhtme:

- i. Koha e vendosjes
- ii. Cmimi (per urdherat fleksibel)

- b) Perputhja e pjesshme e Urdherave

- i. Ne rastin e Urdhërave Fiks, Anëtari pranon përputhjen e pjeshshme të urdherave me cmimin e vendosur nga ky i fundit, deri në masën e plotësimit të shumës totale të urdhërit.
- ii. Në rast të fshirjes së urdhërit Fiks, dhe është përputhur dhe plotësuar vetëm një pjesë e urdhërit fillestar, kjo pjesë e urdhërit do të konsiderohet si e fiksuar dhe e disponueshme menjehere për ekzekutim sipas paragrafit 5.7. pika a.

6.5. Orari i tregtimit

- a) Platforma Union Change është e hapur 24/7.
- b) Transaksionet e kryera në platforme në ditët e shtuna dhe të dielës si dhe ato në ditët e festave zyrtare sipas kalendarit të shpallur nga Banka e Shqipërisë do të procesohen në llogaritë e paleve në ditën e pare të punës pasardhese
- c) Kufizimet e mundshme të orarit të tregtimit do të vendosen nga Administrimi i Union Change dhe do t'u komunikohen Anetareve pa vonese.

6.6. Vendosja dhe fshirja e urdherave

- a) Anetari mund të vendosë ndryshoje ose fshijë urdhera nga platform gjatë kohës së tregtimit të specifikuar nga Union Change dhe në varesi të kërkesave dhe kufizimeve të specifikuar në këto rregullore.
- b) Në rastin e urdherave Fiks, urdherat do të qëndrojnë të hapur për tu përputhur për sa kohë që Anëtari nuk i fshin ato duke ndjekur logjikën “Good Till Canceled”.

6.7. Administrimi i udhërave

- a) Te gjitha urdherat FIKS të vendosur në platform do të konsiderohen si të fiksuar dhe të disponueshem për ekzekutim dhe prandaj, në momentin kur ekzekutohen, edhe pse në mënyrë të pjeshshme, do të krijojnë një detyrim kontraktor detyrues për Anetarin (përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këto rregullore) që ka vendosur urdherin, edhe nëse urdheri është vendosur në emër të një pale të trete.
- b) Te gjitha urdherat FLEKSIBEL të vendosur në platform do të konsiderohen si të fiksuar dhe të disponueshem menjehere për ekzekutim dhe prandaj krijojnë një detyrim kontraktor detyrues për Anetarin (përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këto rregullore) që ka vendosur urdherin, edhe nëse urdheri është vendosur në emër të një pale të trete.
- c) Anetari që vendos urdhera në platformen Union Change duhet, në çdo kohë, të sigurojë parandalimin e vendosjes së urdherave të gabuar.

6.8. Pezullimi i ekzekutimit automatik

- a) Operatori i Union Change mund të pezullojë ekzekutimin automatik të Urdhërave në platformen Union Change në një ose më shumë monedha nëse:
 - i. Administrimi i Union Change konstaton që ka ndodhur ose ka mundësi të ndodhë një problem në sistemin e platformes;
 - ii. kërkohej nga Autoriteti Kompetent;
 - iii. Konsideron, në lirinë e tij të plotë, se ka ose ka mundësi të ketë një rrezik për stabilitetin e tregut të rregullt dhe të ndershem;

- iv. Nese Operatori i Union Change, ne lirine e tij te plote, e konsideron te arsyeshme te veproje keshtu.
- v. Nese Operatori i Union Change, ne lirine e tij te plote, konsideron qe Anetari nuk ka zabtuar ose ka mundesi te mos zbatoje detyrimet e tij sipas paragrafit 1.3 dhe 4.1.

6.9. Fshirja e nje transaksioni

- a) Operatori i Union Change ka lirine te fshije nje transaksion ne cfaredolloj rrethane kur ai e konsideron te pershtatshme, perfshire por jo kufizuar nga rrethanat kur Administrimi i Union Change vendos qe transaksioni perben urdher te gabuar.
- b) Administrimi mund te kontaktoje Anetarin (por nuk ka detyrim ta beje) per te verifikuar vlefshmerine e Urdherit.
- c) Nese merr ne konsiderate nje fshirje te nje Urdheri ose transaksioni, Administrimi i Union Change do te marre parasysh:
 - i. Shumen e urdherit apo transaksionit;
 - ii. Cmimin e urdherit apo transaksionit

7. RREGULIMI DHE SHLYERJA E LLOGARIVE

7.1. Kunderpala Qendrore e Shlyerjes

- a) Kunderpala Qendrore e Shlyerjes eshte pergjegjese per kryerjen e te gjitha pagesave qe gjenerohen nga transaksionet e kembimeve valutore te kryera ne platformen Union Change. Në çdo rast Operatori është I përjashtuar nga pretendimi për kryerjen e pagesave.
- b) Pjesmarresit jane te detyruar te celin llogari prane Kunderpales Qendrore, ne te gjitha monedhat e tregtueshme ne Union Change dhe t'i mbajne ato te hapura per sa kohe jane pjesmarres ne kete platforme.

7.2. Procesi i rregullimit dhe shlyerjes se llogarive

- a) Ekzekutimi i pagesave te gjeneruara nga transaksionet e kryera ne Union Change behet nepermjet debitimit direkt te llogarive te pjesmarresve ne Programin Union Change të celura prane Kunderpales Qendrore.
- b) Pjesmarresist jane pergjegjjes per krijimin dhe mbajtjen ne llogarite e tyre te fondeve te mjaftueshme dhe te lira nga bllokimi per çfare do arsye per te bere te mundur kryerjen papenguar te pagesave te gjeneruara nga transaksionet ne Union Change.
- c) Ne rast se Pjesmarresi nuk ka fonde te mjaftueshme per te kryer pagesat qe rrjedhin nga nje transaksion i kryera ne Union Change, atehere ai transaksion do te bllokohet nga platforma dhe nuk do te kryhet.
- d) Kunderpala Qendrore, ne gjykimin e saj te lire, mund te perjashtoje nga ekzekutimi I pagesave bazuar ne debitimin direkt, ata pjesmarres ne platformen Union Change qe kane kontrate kembimi valutor dhe marreveshje kolaterali financiar me te. Ne kete rast, rregullimi dhe pastrimi i llogarive behet bazuar ne kontraten e kembimit valutor dhe marreveshjen e kolateralit financiar mes pjesmarresit ne Union Change dhe Kunderpales Qendrore.

7.3. Procesi i bllokimit të fondeve në llogari

- a) Në rastin e urdhërave Fiks, Kundërpala Qendrore e Shlyerjes do të bllokojë fondet në llogarite perkatese të Anëtarit, në masën e shumave të urdherave të vendosura për shitblerje.
- b) Fondet do të qendrojnë të bllokuara derisa urdhërat të perputhen ose të fshihen nga ana e klientit që i ka vendosur apo Operatorit sipas nenit 5.9.
- c) Në rastin e perputhjes së pjesshme, fondet do të lirohen në masën e përpjesës së urdhërit të perputhur.

8. DESHTIMI

- 8.1. Nëse, në çdo kohë, një Anetar peson një Ngjarje Deshtimi, Union Change mund të ndermarre veprimet që i konsideron të pershtatshme në gjykimin e vetëm të saj. Këto veprime mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në to si më poshtë”
- a) Të fshijë disa ose të gjitha Urdherat e paekzekutuar nga platforma Union Change;
 - b) Të pezullojë Anëtarin nga pjesëmarrja nga platforma Union Change;
 - c) Të trajtojë ndonjë apo të gjithë Urdherat e pakryera si të anuluar nga Anetari dhe, në këtë rast, detyrimet e Union Change në lidhje me këto Urdhëra do të konsiderohen të anuluar dhe të përfunduara.
 - d) U change nuk është përgjegjëse dhe nuk ka asnjë detyrim në rast falimentimi të një Anetari në lidhje me transaksionet e kryera në Union Change. Transaksionet e kryera nëpërmjet Union Change nuk janë subjekt i asnjë skeme kompensimi.

9. INFORMACIONI, MONITORIMI DHE HETIMI

9.1. Monitorimi

- a) Operatori i Union Change do të monitorojë zbatimin e Rregullores, kushtet e tregimit dhe sjelljet abuzive të Anëtareve.
- b) Operatori i Union Change do të ndihmojë çdo Autoritet Kompetent ose autoritet mbikqyres apo hetues publik, në çdo hetim për abuzim me tregun.

9.2. Informacioni

- a) Çdo Anetar duhet të njoftojë menjëherë Administrimin e Union Change nëse vihet në dijeni të një shkeljeje të rëndësishme të Rregullores nga ana e tij apo e çdo Anetari tjetër.
- b) Administrimi i Union Change mund të kërkojë dënimin e menjëhershëm të informacionit rreth Urdherave apo Transaksioneve Perkatese në çfarëdo formati të specifikuar nga platforma Union Change.
- c) Pavarësisht nga neni 1.4, Administrimi i Union Change mund të bejë të ditur çdo informacion ose dokument me qëllim krijimin e mundësive për fillimin, vazhdimin ose mbrojtjen në çdo proces, përfshirë proceset gjyqësore, ku Union Change është pale.
- d) Union Change mund të mbajë informacionin dhe dokumentet që mund të marrë në zotërim në lidhje me këto Rregullore për një periudhë kohore që e konsideron të pershtatshme.

9.3. Hetimi i shkeljeve

- a) Nese Administrimi i Union Change ka vlersuar, ne gjykimin e tij te plote, se ka pasur nje shkelje te Rregullores, Operatori i Union Change do te marre ne konsiderate te gjitha rrethanat e rastit me qellim marrjen e vendimit nese duhen zbatuar sanksionet sipas nenit 8.5. Ne vendimarrjen lidhur me zbatimin eventual te sanksioneve Administrimi i Union Change do te konsideroje faktoret e meposhtem:
- i. Natyren dhe seriozitetin e shkeljes;
 - A. Nese shkejla eshte e rendesishme per funksionimin e rregullt te tregut;
 - B. Nese shkelja eshte e qellimshme ose nga pakujdesia si dhe nese Anetari veproi ma integritet gjate shkeljes apo hetimit te mevonshem;
 - C. Ndikimi i shkeljes mbi funksionimin e rregullt te tregut apo nese eshte demtuar integriteti i Union Change;
 - D. Kohezgjatja dhe shpeshtesia e shkeljes;
 - E. Shuma e perfituar apo humbja e evituar si rezultat i shkeljes;
 - F. Nese ka nje numer shkeljesh te vogla, qe individualisht nuk justifikojne zbatimin e sanksioneve, por te konsideruara kolektivishtie justifikojne sanksionet.
 - ii. Sjelljen e Anetarit para dhe pas shkeljes;
 - A. Nese Anetari do ta sillte shkeljen ne vemendjen e Administrimit te Union Change edhe pa e zbuluar kjo e fundit;
 - B. Shkallen e bashkepunimit te Anetarit gjate hetimit te shkeljes;
 - C. Gjasat qe kjo shkelje te perseritet ne rast moszbatimi te sanksioneve;
 - iii. Historikun e respektimit te rregullave nga Anetari;
 - A. Nese Anetari eshte kapur me pare ne kryerje te shkeljeve te Rregullores;
 - B. Nese Anetari eshte sanksionuar me pare per shkeljen ne fjale;

9.4. Ndhma ne hetim

- a) Anetaret do te sigurojne gjithë ndihmen e arsyeshme te kerkuar nga Operatori i Union Change apo punonjesit e saj ne lidhje me hetimin e shkeljeve. Kjo ndihme duhet te jepet brenda afatit kohor te specifikuar nga Operatori i Union Change dhe do te perfshije:
- i. Dhenien e te gjithë informacionit dhe dokumenteve te kerkuara nga nga Operatori i Union Change;
 - ii. Akses ne ambientet dhe personat qe punojne per Anetarin;

9.5. Sanksionet

- a) Per mirefunksionimin e nje tregu te ndershem dhe te rregullt, Operatori i Union Change mund te vendose ndonje apo te gjitha sanksionet e meposhtme per shkeljen e Rregullores nga nje Anetar dhe do te informajo nje Anetar lidhur me çdo vendim per vendosjen e secilit prej sanksioneve te meposhtme:
- i. Verejtje me shkrim;
 - ii. Pezullim i perkohshem;
 - iii. Vendosjen e nje gjobe;
 - iv. Leshimi i nje paralajmerimi per perjashtim;
 - v. Perjashtim nga pjesmarrja ne platform;

9.6. Ankesat

- a) Çdo ankese per sjelljen e nje Anetari ose dyshim se ai mund te kete kryer ose eshte duke kryer nje shkelje te kesaj Rregullore duhet, aty ku eshte e mundur, te behet me shkrim dhe t'i adresohet Union Change.
- b) Nese Union Change konsideron se ankesa eshte e bazuar, atehere mund t'i rekomandoje Supervizorit Union Change qe te nise nje hetim me objekt shkeljen potenciale te Rregullores. Operatori i Union Change mund t'i jape njoftim Anetarit lidhur me rezultatet e ketij hetimi, duke perfshire edhe sanksionet eventuale sipas paragrafit 8.5 te kesaj Rregullore.

9.7. Heqje dore

Operatori i Union Change mund, ne lirine e tij te plote, te heqe dore nga detyrimi per zbatimi te kesaj Rregulloreje, por kjo heqje dore nuk do te pengoje apo kufizojte Administrimin e Union Change qe te veproje per zbatimin e Rregullores si ne lidhje me ndonje shkelje tjeter te saj, ashtu edhe kunder çdo Anetari tjeter ne lidhje me te njeften shkelje.